



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 350/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.05.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Sabeta” shpk dhe skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë Për Propozime” me Nr. REF-23947-02-14-2016 me objekt: *“Shërbimi privat i sigurisë fizike, ruajtja e vlerave monetare e materiale dhe verifikimi i sinjalit të alarmit në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukës për periudhën Mars - Dhjetor 2016”, me fond limit 6.000.000 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 01.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.*

Ankimues:

“Nazeri 2000” sh.p.k.
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kulla H, Ap.27, Tiranë .

“Shtiqni ” shpk.
Lagje nr.4, Pallati 8, ap.3, Kukës.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.
Rruga e Spitalit, qyteti Kukës, rrethi Kukës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar ato, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 15.02.2016 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë Për Propozime” me Nr. REF-23947-02-14-2016 me objekt: “Sherbimi privat i sigurisë fizike, ruajtja e vlerave monetare e materiale dhe verifikimi i sinjalit të alarmit në Drejtorinë e Sherbimit Spitalore Kukes për periudhën Mars - Dhjetor 2016”, me fond limit

6.000.000 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 01.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

II.2. Në datën 01.03.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.03.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Sabeta” shpk	5,575,151.90	I kualifikuar
- “Nazeri 2000” shpk	5,575,151.90	I skualifikuar
- “Shtiqni” shpk	5,581,685.67	I kualifikuar
- “Eurogjici Security” shpk	pa ofertë	I skualifikuar
- “Trezhnjeva” shpk	pa ofertë	I skualifikuar

II.4. Në datën 10.03.2016 operatori ekonomik “Nazeri” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij për arsyen se : *“Dy leje/certifikata punonjës shërbimi roje të lëshuara nga Drejtoria e Policisë janë me afat të skaduar e për rrjedhojë ulet numri i punonjësve të certifikuar në 11 punonjës nga 12 të certifikuar/leje të kërkuar nga autoriteti kontraktor”*.

Në datën 15.03.2016 operatori ekonomik “Nazeri” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke paraqitur argumentimet si më poshtë vijon:

1. Për sa i përket arsyes së skualifikimit të shoqërisë sonë me pretendimin se : *“a) “Dy leje/certifikata punonjës shërbimi roje të lëshuara nga Drejtoria e Policisë janë me afat të skaduar e për rrjedhojë ulet numri i punonjësve të certifikuar në 11 punonjës nga 12 të certifikuar/leje të kërkuar nga autoriteti kontraktor”, shprehemi së në DST , shtojca 7, kapaciteti teknik pika 6, AK ka kërkuar: “6. Leje për ushtrimin e profesionit për të punësuarit, lëshuar nga Drejtori i Policisë së Qarkut përkatës, në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit.”*.

Pra në DST , Autoriteti Kontraktor në asnjë paragraf nuk është shprehur se kërkon 12 leje punonjësish lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut apo të përcaktojë se i kërkon këto leje me një numër të caktuar.

Referuar nenit 46, pika 1 dhe nenit 53/3 të LPP-së AK nuk mund të skualifikojë shoqërinë tonë për një kriter për të cilin në dst nuk është kërkuar që të përmbushet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk mund të përdorë kritere të cilat nuk janë të vendosura në DST, por duhet t’i vlerësojë ato referuar kërkesave të publikuara para zhvillimit të procedurës së prokurimit publik. Dhe nga ana e AK në shtojcën e publikuar kërkesa për leje punonjësish ka qenë e shprehur:

“1. Leje për ushtrimin e profesionit për të punësuarit, lëshuar nga Drejtori i Policisë së Qarkut përkatës, në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit.”, pa përcaktuar se kërkon ndonjë numër të caktuar punonjësish.

Përfundimisht AK duhet të kualifikojë shoqërinë tonë pasi arsyeja e skualifikimit nuk qëndron dhe është e pabazuar pasi AK nuk mund të skualifikojë shoqërinë tonë për një kriter që nuk është vendosur në dst.

2. Skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Sabeta” shpk, pasi kjo shoqëri nuk ka përmbushur:
2.1 “a) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

Kjo shoqëri nuk ka paraqitur vërtetim ku të ketë shlyer detyrimet për muajin Janar 2016.

2.2 Shoqëria “Sabeta” shpk nuk ka përmbushur pikën 2,3,4 të kapacitetit teknik ku kërkohet:

“2. Çertifikatë e titullarit të subjektit, kategoria (I.3.A) lëshuar në bazë të ligjit Nr.75\2014 «Për shërbimin privat të sigurisë fizike»”

3. “Licencë për ushtrimin e aktivitetit, kategoria (I.3.A) lëshuar nga QKL-ja, konform Ligjit Nr.10081, datë 23.02.2009 «Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë», konform Ligjit Nr.75\2014 «Për shërbimin privat të sigurisë fizike».”

4.« Çertifikatë e drejtuesit teknik të shoqërisë për kategorinë (I.3.A) konform Ligjit Nr.75/2014 «Për shërbimin privat të sigurisë fizike».

Kjo shoqëri nuk përmbush kërkesën e dhënë nga AK për Çertifikatë të titullarit të subjektit dhe Çertifikatë të drejtuesit teknik pasi çertifikatat e paraqitura nga kjo shoqëri nuk janë të vlefshme dhe nuk janë në përputhje me Ligjin për SHPSF nr.75/2014 datë 10.07.2014, Neni 49.

Gjithashtu edhe licenca e lëshuar nga QKL për këtë shoqëri nuk është në përputhje me Ligjin për SHPSF nr.75/2014 datë 10.07.2014, Neni 6, pika 3.

Public Health Sector

Për sa më sipër kërkohet nga AK kualifikimin e shoqërisë sonë, dhe skualifikimin e shoqërisë “Sabeta” shpk

II.5. Në datën 16.03.2016, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 21.03.2016, pala ankimuese “Nazeri 2000” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe kërkon kualifikimin e tij si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Sabeta” shpk.

II.7. Në datën 10.03.2016 operatori ekonomik “Shtiçni” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe paraqet argumentat si më poshtë vijon

Në datën 15.03.2016 operatori ekonomik “Shtiçni” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke paraqitur argumentimet si më poshtë vijon:

“Skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Sabeta” shpk, pasi oferta e paraqitur prej kësaj shoqërie është nën koston e lejuar ligjore, pasi përllogaritjet e bëra nuk janë në përputhje me LPP dhe Rekomandimin e APP-së dhe KPP-së të datës 01.04.2015 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike”, ku nga përllogaritjet e bëra prej nesh rezulton:

“Për një vend-roje me 4.72 roje rezulton nën kosto ligjore”.

“Oferta e paraqitur për një vendroje me 2.56 roje rezulton nën kosto ligjore.”

Operatori ekonomik “Sabeta” shpk nuk ka përlllogaritur ofetën e paraqitur në përputhje me legjislacionin në fuqi (Kodi i Punës Neni 81/1 dhe Neni 87; VKM nr.1114 datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993”Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; Urdhërit të Minsitrit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë nr.3644 datë 07.12.2001”Për aplikimin e tarfiave në kryerjen e shërbimit ndaj të tretëve”)”.

Për sa më sipër Operatori ekonomik “Sabeta” shpk duhet të skualifikohet pasi është ofertë nën koston ligjore.

“Operatori Ekonomik Nazeri 2000 të rrijë i skualifikuar, sepse ka ofertuar nën koston ligjore”.

II.8. Në datën 18.03.2016, operatori ekonomik ankimues “Shtiqni ” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.9. Në datën 21.03.2016, pala ankimuese “Shtiqni ” shpk. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Sabeta” shpk, dhe operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk të rrijë i skualifikuar.



pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Dy leje/certifikata punonjës shërbimi roje të lëshuara nga Drejtoria e Policisë janë me afat të skaduar e për rrjedhojë ulet numri i punonjësve të çertifikuar në 11 punonjës nga 12 të çertifikuar/leje të kërkuar nga autoriteti kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..”

III.1.2. Në shtojcën “Modifikim në dokumentat standarte” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor përcaktohet se:

Pika 6 e kapacitetit ekonomik dhe financiar: “Listëpagesat e detyrimit të sigurimit shoqëror për periudhën shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2015 jo më pak se numri i rojeve që kërkohen (12 punonjës të siguruar) për realizimin e kontates (ku te jete perfshire titullar/administrator dhe drejtuesi teknik) shoqeruar me vertetimin e administrates tatimore qe verteton se ofertuesi ka paguar detyrimet e sig. shoqerore. ”.

Pika 6 e kapacitetit teknik: “6.Leje për ushtrimin e profesionit për të punesuarit, lëshuar nga Drejtori i Policisë së Qarkut përkatës, në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit.”

Në Shtojcën 11:Shërbimi dhe Grafiku i ekzekutimit percaktohet:

Numri i vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i kontrates	Fondi Limit pa TVSH	Fondi Limit me TVSH
2	3	9.44	10 muaj	6.000.000	7.200.000
1	2	2.56			

Nga përcaktimi i mësipërm rezulton: Numri i rojeve të nevojshme $9.44 + 2.56 = 12$ punonjës shërbimi (roje).

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E) operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nr.148 prot. dt.03.02.2016 i Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës ku janë bashkangjitur edhe çertifikatat për 13 punonjësit e shërbimit .

III.1.4. Referuar sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues me anë të dokumentacionit të paraqitur nuk ka plotësuar kërkesat e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit lidhur me 12 punonjës shërbimi të çertifikuar/pajisur me lejë për ushtrimin e profesionit, pasi me Vërtetimin nr.148 prot.dt.03.02.2016 të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës ku janë bashkangjitur edhe çertifikatat për punonjësit e shërbimit, rezulton se vërtëtimi i lëshuar për 13 punonjës shërbimi dhe çertifikimi për ta daton në vite të ndryshme.

Referuar Ligjit nr.75/2014 çertifikatat lëshohen për një afat 4 vjeçar.

Konkretisht çertifikatat për 2 punonjës shërbimi të OE ankimues “Nazeri 2000” shpk, rezultojnë të ketë kaluar afatin ligjor 4 vjeçar në rastin e punonjësit R.M me nr.çertifikate 259/2 datë 16.03.2010 (afati i skadimit viti 2014); dhe në rastin e punonjësit I.T me nr.çertifikate 1140/1 datë 25.12.2009 (afati i skadimit viti 2013).

Çertifikimi i subjekteve ‘punonjesi shërbimi’, është nje dokument qe verteton aftesine e ketyre te fundit per ushtrimin e detyrave perkatese ne fushen e shërbimit privat te sigurise fizike.

Meqënëse 2 çertifikata për 2 punonjës shërbimi të paraqitur prej operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk janë jashtë afatit të tyre të vlefshmërisë, rezulton se nga 13 punonjës shërbimi

që figurojnë në listën emërore, mbeten 11 punonjës shërbimi të çertifikuar brenda afitit të vlefshmerisë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” sh.p.k nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” sh.p.k mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sabeta” shpk Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje se Neni 63, pika 1 e LPP kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimes edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k lidhur me operatorë të tjerë ekonomikë nuk merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Shtiqni” sh.p.k për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sabeta” shpk “*pasi oferta e paraqitur prej kësaj shoqërie është nën koston e lejuar ligjore*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 të modifikimeve të dokumentave të tenderit “Kriteret e Veçanta” pika 5 “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” të procedurës objekt ankimesi përcaktohet se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizen e kostos për një roje (sipas pasqyres së shtojcës nr 1 e cila do të jetë bashkangjitur me formularin e ofertes) duke u mbështetur në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, të nenit 81 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohezgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, të VKM-së nr. 573, date 03.07.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, të Urdhrit të Ministrisë së Rendit publik nr 3644, datë 07.12.2001 etj. Operoret ekonomike të respektojnë të gjitha detyrimet ligjore të percaktuara në ligjin nr.75/2014. Udhezimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.157, date 01.04.2015 dhe të akteve nenligjore që rrjedhin në zbatim të tyre.”

III.3.2. Në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit “*Specifikimet Teknike*”, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Te dhena për shërbimin e kerkuar

- *Sherbimi do të kryehet me 3 vend-roje një në maternitet dhe dy në Spital me tre turne, shërbim -24 ore panderprerje.*
- *Gjate turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle cdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.*
- *Rojet e turnit të tretë të jete të pajisur me arme.*

Kërkesat per zbatimin e shërbimit

- *Personeli te jete i licensuar me lejet perkatese te leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut ku prokurohet ne baze te legjislacionit ne fuqi.*
- *Te jete i pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise dhe te kene dokumenta qe vertetojne identitetin e tyre.*
- *Rojet duhet te kene ne perdorim per realizimin e sherbimit te ruajtjes, radio komunikimi.*
- *Rojet duhet te kene leje arme.*

III.3.3. Në Shtojcën 11 të modifikimit të dokumentave të tenderit “shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Sherbim privat i sigurise fizike, ruajtja e vlerave monetare e materiale dhe verifikim i sinjalit te alarmit i objekteve te Sherbimit Spitalor Kukes, me Roje Objekti per 24 ore.

Numri i vend rojeve eshte 2 (dy) me 4.72 roje.

Numri i vend rojeve eshte 1 (nje) me 2.56 roje

<i>Numri i vendrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve te nevojshme</i>	<i>Afati i kontrates</i>	<i>Fondi Limit pa TVSH</i>	<i>Fondi Limit me TVSH</i>
2	3	9.44	10 muaj	6.000.000	7.200.000
1	2	2.56			

Sherbimet do te kryhen per 24 ore me roje ne:

1-Ne godinen e maternitetit te Kukesit do te jete nje vend-roje ku sherbimi do te jete me tre turne.

2-Ne godinen e spitalit te Kukesit do te jete nje vend-roje ku sherbimi do te jete me tre turne dhe nje vend roje me dy turne.

Godina e Spitalit Kukes me adrese kryesore Rruga: Rruga e Spitalit, Qyteti Kukes sherbimi do te kete 2(dy) vend roje, ku njeri eshte me sherbim tre turne dhe tjeteri me sherbim me dy turne.

[.....]

Sherbimi i ruajtjes e sigurimit fizik te objekteve do te jete 24 ore per cdo dite kalendarike, sipas afateve te kontrates.

Afatet e ekzekutimit:

Sherbimi do te kryhet per periudhen Mars-Dhjetor 2016.

III.3.4. Në shtojcën 12 të modifikimeve të dokumentave të tenderit “Termet e referencës” përcaktohet se :

Objekti dhe qellimi i sherbimeve: Sherbim privat i sigurise fizike, ruajtja e vlerave monetare dhe materiale dhe verifikim i sinjalit te alarmit ne Spitalin Kukes per periudhen mars-dhjetor 2016.

Shpërndarja:

Detyrat: Roja ka per detyre:

Të bëhet sipas turneve, për të siguruar mbulimin e tyre me shërbimin e rojeve gjatë 24 oreve për çdo ditë kalendarike (nga ora 00^{oo} deri në ora 24^{oo}). Numri i punonjesve të shërbimit duhet të jete 4.

[.....]

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, me adresë rruga e Spitalit, qyteti Kukës, rrethi Kukës

III.3.5. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: *“Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.*

III.3.6 Në VKM nr. 573, datë 03.7.2012 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: *“Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzetë e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”.*

III.3.7. Në nenin 81 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: *“Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtesë mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”, ndërsa referuar nenin 87, po këtu, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj. ”*

III.3.8. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.3.9. Përveç shpenzimeve për pagën e punonjësve dhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, në koston për një roje në muaj përfshihen edhe shpenzimet minimale të armatimit, sipas Udhëzimit nr. 157, datë 1.4.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”.

III.3.10. Nisur nga baza ligjore e sipërcituar si dhe nga kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik pas përlllogaritjeve të kryera, konstaton se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Sabeta” sh.p.k total është në koston e lejuar ligjore pasi oferta e tij është përlllogaritur në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për pagën minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e II dhe të III, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7% si dhe shpenzimet për armatim e rrjedhimisht mjafton për mbulimin e shpenzimeve për periudhën e kërkuar të kryerjes së shërbimit të ruajtjes me roje në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Shtiqni” sh.p.k, nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Shtiqni” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës

administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1. e në vijim, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Shtiqni” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë Për Propozime*” me Nr. REF-23947-02-14-2016 me objekt: “*Sherbimi privat i sigurise fizike, ruajtja e vlerave monetare e materiale dhe verifikimi i sinjalit te alarmit ne Drejtorine e Sherbimit Spitalore Kukes per periudhen Mars - Dhjetor 2016*”, me fond limit 6.000.000 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 01.03.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.616 Prot ; Datë 21.03.2016

Nr.618 Prot ; Datë 21.03.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Mendim kundër

Unë, anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik, Juliana Hoxha jam kundër vendimit të shumicës të anëtarëve, në lidhje me arsyetimin e vendimit në pikën III.3 e në vijim për procedurën e prokurimit me objekt *“Shërbimi privat i sigurisë fizike, ruajtja e vlerave monetare e materiale dhe verifikimi i sinjalit të alarmit në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukës për periudhën Mars - Dhjetor 2016”*, me fond limit 6.000.000 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 01.03.2016 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Shtiqni” sh.p.k për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Sabeta” sh.p.k, për arsye se *“oferta e paraqitur është nën koston ligjore”* vërej se:

I.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

I.3. Në Ligjin nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”*, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: *“Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.*

I.4. Në VKM nr. 573, datë 03.7.2012 *“Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”*, përcaktohet shprehimisht: *“Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzetë e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”.*

I.5.Neni 81 *“Shtesa Mbi Pagë”*, i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht se: *“Çdo orë pune e kryer nga ora 1900 deri në 2200 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 për qind. Çdo orë pune e kryer midis intervalit 2200 dhe 600 jep të drejtë e një shtese mbi pagë jo më pak se 50 për qind. “*

Ndërsa neni 87 “Puna në ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare” parashikon shprehimisht se: “Puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë page jo më pak se 25 për qind ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj.”

I.6. Neni 92 i Kodit të Punës i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim. Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.”

I.7. Në shtojcën 7 të modifikimeve të dokumentave të tenderit “Kriteret e Veçanta” pika 5 “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” të procedurës objekt ankimi përcaktohet se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizën e kostos për një roje (sipas pasqyrës së shtojcës nr 1 e cila do të jetë bashkëgjatë me formularin e ofertës) duke u mbështetur në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, të nenit 81 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, të VKM-së nr. 573, datë 03.07.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, të Urdhrit të Ministrisë së Rendit Publik nr 3644, datë 07.12.2001 etj. Operatorët ekonomikë të respektojnë të gjitha detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr.75/2014, Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.157, datë 01.04.2015 dhe të akteve nënligjore që rrjedhin në zbatim të tyre.”

I.8. Në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit “Specifikimet Teknike”, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“Te dhena per shërbimin e kerkuar

- Sherbimi do te kryehet me 3 vend-roje nje ne maternitet dhe dy ne Spital me tre turne, shërbim -24 ore panderprerje.
- Gjate turneve te dyta dhe te treta rojet te kryejne kontrole cdo 15 minuta ne te gjitha hapësirat e objekteve.
- Rojet e turnit te trete te jete te pajisur me arme.”

I.9. Në Shtojcën 11 të modifikimit të dokumentave të tenderit “shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“Sherbim privat i sigurise fizike, ruajtja e vlerave monetare e materiale dhe verifikim i sinjalit te alarmit i objekteve te Sherbimit Spitalor Kukes, me Roje Objekti per 24 ore.

Numri i vend rojeve eshte 2 (dy) me 4.72 roje.

Numri i vend rojeve eshte 1 (nje) me 2.56 roje

Numri i vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i kontrates	Fondi Limit pa TVSH	Fondi Limit me TVSH
2	3	9.44	10 muaj	6.000.000	7.200.000
1	2	2.56			

Sherbimet do te kryhen per 24 ore me roje ne:

1-Ne godinen e maternitetit te Kukesit do te jete nje vend-roje ku sherbimi do te jete me tre turne.
2-Ne godinen e spitalit te Kukesit do te jete nje vend-roje ku sherbimi do te jete me tre turne dhe nje vend roje me dy turne.

[.....]

Sherbimi i ruajtjes e sigurimit fizik te objekteve do te jete 24 ore per cdo dite kalendarike, sipas afateve te kontrates.

Afatet e ekzekutimit:

Sherbimi do te kryhet per periudhen Mars-Dhjetor 2016.

I.10. Në shtojcën 12 të modifikimeve të dokumentave të tenderit “*Termet e referencës*” përcaktohet se :

Objekti dhe qellimi i sherbimeve: Sherbim privat i sigurise fizike, ruajtja e vlerave monetare dhe materiale dhe verifikim i sinjalit te alarmit ne Spitalin Kukes per periudhen mars-dhjetor 2016.

[.....]

Shpërndarja:

Detyrat: Roja ka per detyre:

Të bëhet sipas turneve, për të siguruar mbulimin e tyre me sherbimin e rojeve gjatë 24 oreve per çdo dite kalendarike (nga ora ora 00^{oo} deri ne ora 24^{oo}). Numri i punonjesve te sherbimit duhet te jete 4.

[.....]

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes, me adrese rruga e Spitalit, qyteti Kukes, rrethi Kukes

I.11. Sa më sipër, përveç shpenzimeve për pagën e punonjësve, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore, shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, në përlllogaritjen e kostos duhet të përfshihen dhe **shpenzimet për leje vjetore, ditët e festave e pushimet zyrtare në përputhje me ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 Kodi i Punës, Kreu IX, Kohëzgjatja e punës dhe e pushimeve, neni 76 e vijues**”

I.12. Nisur nga parakushti i mësipërm, vlerësoj se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Sabeta” shpk, nga përlllogaritjet e kryera rezulton se, ky i fundit, nuk ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi për shtesat mbi pagë për ditët e festave dhe pushimit javor, lejen vjetore në përputhje me bazën ligjore të cituar më sipër, gjë që sjell si pasojë faktin se kjo shoqëri, me ofertën ekonomike të dorëzuara prej tij, nuk mundëson dot kryerjen e këtij shërbimi duke respektuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi sikundër citohen më sipër.

Kjo përputhet me qëndrimin koherent të mbajtur në vazhdimësi duke vlerësuar si të rëndësishme përlllogaritjen në funksion të respektimit të dispozitave ligjore në fuqi, të shtesave mbi pagë për ditët e festave, pushimit javor, lejen vjetore bazuar në Kodin e Punës.

Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruara prej operatorit ekonomik ankimues “Shtiqni sh.p.k qëndron.

Anëtare

Juliana Hoxha